

**KONTRATË SHITJE**  
**E PJESEMARRJES SË KAPITALIT TË SHOQËRISË**  
**“Klea & Lois” SHPK**

Lidhur sot, në Tiranë, më 05.02.2020, midis paleve si ne vijim:

**Shitesi:** z. Neshat Fana, shtetas shqiptar, lindur me 30.12.1960, ne Peshkopi dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr. G01230021C

**Dhe**

**Bleresi:** znj. Valdete Sulejmani, shtetase shqiptare, lindur më 01.09.1978, ne Peshkopi, Diber dhe banuese në Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtëse e dokumentit te identifikimit me nr. H85901141N.

**Baza Ligjore:** Neni 73, i ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, Kodi Civil i R. Sh, neni 705 e vijues,

Palet ose perfaqesuesit e tyre jane madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar dhe gezojne te gjitha cilesite dhe kompetencat per te realizuar kete kontrate. Keto pale ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote dhe ne baze te Vendimit te Ortakut te vetem, date 18.02.2019, vendosin nëpërmjet kesaj kontrate te transferojne pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerise, se bashku me te drejtat dhe detyrimet e lidhura me kete pjesëmarrje.

**Neni 1 - Shitja e 50% te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar të shoqërisë**

Objekt i kesaj kontrate shitblerje eshte shitja nga Shitesi tek Bleresi i 50% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise Klea & Lois shpk, qe zoteron Shitesi, Neshat Fana si dhe te drejtave reale si dhe interesave pasurore te lidhura me kete pjesemarrje, te drejta keto qe mund te vijne tani ose ne te ardhmen, duke njohur bleresin, znj. Valdete Sulejmani, si pronare ligjore te kesaj pjesemarrje, si dhe blerja e 50% te kapitalit te shoqerise Klea & Lois shpk, nga Bleresi, si dhe cdo lloj te drejte reale, si dhe interesat pasurore te lidhura me kete pjesemarrje ne kapital, te drejta keto qe mund te vine tani ose ne te ardhmen duke njohur bleresin si te vetmin pronar ligjor.

**Neni 2 - Çmimi i shitjes**

50% e pjesemarrjes se zoteruar nga ortakut Neshat Fana i shiten znj. Valdete Suljemani per vleren prej 50.000 leke (pesedhjete mije), çmimi i cili eshte shlyer teresisht midis paleve, te cilet e konfirmojne me nenshkrimin e kesaj kontrate.

**Neni 3 - Të drejtat dhe detyrimet e blerësve**

1. Blerësi detyrohet të marre në dorëzim në rregull me inventare cdo aset të shoqërisë, si dhe të gjitha faturat që provojnë të drejtat dhe detyrimet që ka shoqëria ndaj të tretëve.
2. Bleresi ka të drejtë të arkëtojë të hyrat e paarkëtuara, si dhe detyrohet të shlyejë cdo detyrim të shoqërisë ndaj të tretëve te detajuara keto ne proces verbalet e pranuar dhe te nenshkruara nga te dyja palet para nenshkrimin te kesaj kontrate.
3. Këtë kontratë shitje te pjesemarrjes, bashke me dokumentacionin perkates, t'a depozitojë në Regjistrin Tregtar pranë QKB Tiranë, si dhe të njoftojë ndryshimin e pronësisë mbi shoqërinë: në Zyrën e tatim taksave qendrore dhe vendore, në ISKSH dhe kudo qe mund te kerkohet ne baze te ligjit.



#### **Neni 4 - Të drejtat dhe detyrimet e shitësit**

Shitesi deklaron se ai zoteron pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerise, objekt i kesaj kontrate dhe gezon te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe jane te lidhura me to.

Nuk rezulton qe te kete subjekte / persona te trete qe te kene pretendime mbi pasurite e shoqerise dhe/ose kuotat ne shitje.

Cdo detyrim i njohur i shoqerise Klea & Lois shpk eshte i regjistruar rregullisht ne pasqyrat e saj financiare dhe nuk ka detyrime te tjera te fshehura te shoqerise per te cilen bleresi si ortak te jete ne dijeni;

Shitësi detyrohet të dorëzojë vec listes se asetëve (inventarit të makinerive dhe sendeve të luajtshme) edhe të gjithë dokumentacionin origjinal të akteve themeluese, të licensave profesionale, të akteve të Tatimeve, si dhe të gjitha faturat tatimore me të cilat është shitur malli apo është blerë malli ndaj të tretëve deri ne daten e nenshkrimit te kesaj kontrate.

#### **Neni 5 - Transferimi i titullit te pronesise mbi kuotat**

Transferimi i pronesise se pjesemarrjes objekt i kesaj kontrate shitje, nga shitesi tek bleresi, do te behet me lidhjen e kesaj kontrate. Bleresi me lidhjen e kesaj kontrate do te gezoje te gjitha te drejtat tij si ortak ligjor i 50% te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise si dhe do te perballoje teresisht te gjitha detyrimet e lidhura me pronesine e kesaj pjesemarrje. Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar prane QKB, Bleresi ka te drejte te tjetersoje pjeserisht apo teresisht pjesemarrjen objekt i kesaj kontrate.

#### **Neni 6 - Dispozitë tranzitore**

Çdo kontratë qiraje, pune dhe/ose cdo kontrate apo akt tjetër ligjor, i nënshkruar nga shoqëria “Klea & Lois” shpk para hyrjes në fuqi të kësaj kontrate vijon të jetë në fuqi, derisa palët kontraktuese të vendosin ndryshe.

#### **Neni 6 - Hyrja në fuqi**

Kjo kontratë shitjeje e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqërisë “Klea & Lois” sh.p.k përpilohet në kater kopje autentike, e shkruar në dy fletë vetëm nga njëra anë e tyre ne kater kopje, ne gjuhen shqipe dhe hyn në fuqi ne ditën e nenshkrimit te saj.

#### **PALËT KONTRAKTUESE**

**SHITËSI**  
Neshat Fana

*Neshat Fana*

*Neshat Fana*

**BLERËSI**  
Valdete Sulejmani

*Valdete Sulejmani*

*Valdete Sulejmani*